REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ARDJANA A. MEDIU
ADRESA Blv.Deshmoret e Kombit,
Kullat Binjake, Kulla Nr.2, Kati i 7
TEL: 692041001

KONTRATË DHURIMI PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 1619 **Nr. koleksioni: 491**

Tirane më 30/03/2021

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

A2021050620037575998

*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë

A20210506200375759 98

KONTRATË DHURIMI AKSIONESH

Sot, më datë 30/03 2021(dy mijë e njëzet e një), para meje Notere Ardjana A. Mediu, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Tiranë, me zyrë në adresën Tirane, Blv."Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla Nr.2, Kati i 7, u paraqit personalisht:

- **Z.Shefit Kastrati**, shtetas shqiptar, lindur më 22.07.1970, në Brrut, Kukës, dhe banues në Durrës, i identifikuar prej meje me Letërnjoftimin me Nr.036479571 dhe Nr. Personal H00722126W, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Dhe

- **Z. Gani Kastrati,** shtetas shqiptar, lindur më 15.11.1952, në Brrut, Kukës dhe banues në Durrës, i identifikuar prej meje me Letërnjoftimin me Nr.031107938 dhe Nr. Personal F21115099P, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të **shoqërisë "KASTRATI GROUP" SH.A**, me nr. NUIS K21711502V.

Duke qenë se:

- **Shoqëria "ALBANIA GAS TECH" SH.A,** me nr. NUIS L11718501C, zotërohet nga Aksionarët Z. Mujo Nerguti dhe Z. Shefit Kastrati, të cilët me anë të Vendimit të Asamblesë së Aksionarëve Nr. – , Datë 30/03/2021, kanë dhënë miratimin mbi lidhjen e kësaj kontrate dhurimi, për tjetërsimin nëpërmjet dhurimit të aksioneve që përfaqësojnë 50 % të kapitalit të shoqërisë nga z. Shefit Kastrati tek:
- **Shoqëria "KASTRATI GROUP" SH.A,** me nr. NUIS K21711502V, e cila me anë të Vendimit Nr. – , Datë 30/03/2021, ka dhënë miratimin mbi lidhjen e kësaj kontrate dhurimi;

NENI 1

Palët kontraktuese

1. **Z. Shefit Kastrati**, shtetas shqiptar, lindur më 22.07.1970, në Brrut, Kukës, dhe banues në Durrës, i identifikuar prej meje me Letërnjoftimin me Nr. 036479571 dhe Nr. Personal H00722126W, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
   Nga këtu e më poshtë në kontratë referuar si **"DHURUESI".**

2. **Shoqëria "KASTRATI GROUP" SH.A,** me nr. NUIS K21711502V, përfaqësuar nga **Z. Gani Kastrati,** shtetas shqiptar, lindur më 15.11.1952, në Brrut, Kukës dhe banues në Durrës, i identifikuar prej meje me Letërnjoftimin me Nr.031107938 dhe Nr. Personal F21115099P, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

A20210506200375759 98

Nga këtu e më poshtë në kontratë referuar si **"PRANUESI I DHURIMIT".**

NENI 2

Objekti i kontratës

Objekt i kësaj kontrate është kalimi i së drejtës së pronësisë nëpërmjet dhurimit, nga Dhuruesi te Pranuesi i Dhurimit, të 13,174.5 aksioneve, që përfaqësojnë 50 % të kapitalit, që Dhuruesi z. Shefit Kastrati zotëron në shoqërinë "ALBANIA GAS TECH" SH.A me nr. NIPT L11718501C.

NENI 3

Baza Ligjore

3.1. Kjo kontratë hartohet bazuar në nenin 761 e vijues të Kodit Civil të R.SH dhe nenin 117 të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për shoqëritë tregtare" – i ndryshuar.

NENI 4

Vlera e dhurimit

4.1. Dhuruesi ia dhuron pa asnjë kundërshpërblim aksionet objekt të kësaj kontrate, Pranuesit të Dhurimit.

4.2. Pranuesi i Dhurimit, deklaron se pranon t'i dhurohen aksionet objekt të kësaj kontrate.

4.3. Vlera totale nominale e 13.174,5 aksioneve të dhuruara është ALL 50.419.997,205 (pesëdhjetë milion e katërqind e nëntëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë pikë dyqind e pesë Lekë).

NENI 5

Të drejta dhe detyrime

5.1. Dhuruesi garanton Pranuesin e Dhurimit nga pretendimet e mundshme të personave të tretë mbi aksionet objekt të kësaj kontrate.

5.2. Me nënshkrimin e kësaj kontrate dhe regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, pronësia mbi aksionet e specifikuar në nenin 2 të kësaj kontrate, kalon nga Dhuruesi te Pranuesi i Dhurimit.

5.3. Brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate, Pranuesi i Dhurimit duhet të bëj regjistrimin e saj pranë QKB-së (Qendrës Kombëtare të Biznesit).

5.4. Pas nënshkrimit të kontratës dhe regjistrimit të saj në QKB, Dhuruesi humbet të gjitha të drejtat e pronësisë mbi aksionet objekt të kësaj kontrate.

NENI 6

Hyrja në fuqi

A20210506200375759 98

6.1. Kjo kontratë hartohet në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe.

6.2. Në rast mosmarrëveshjesh në lidhje me interpretimin e kontratës, palët do t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për zgjidhjen e tyre.

6.3. Kontrata hyn në fuqi me nënshkrimin e saj prej palëve.

Kjo kontratë pasi iu lexua palëve dhe si u gjet konform vullnetit të tyre të lire dhe të plotë, u nënshkrua prej tyre, para meje noteres. Pas nënshkrimit të kësaj kontrate nga palët, unë noterja e nënshkruaj rregullisht sipas ligjit.

PALËT KONTRAKTUESE

DHURUESI

Z.Shefit Kastrati

SHEFIT KASTRATI

PRANUESI I DHURIMIT

"KASTRATI GROUP" SH.A

Përfaqësuar nga Z. Gani Kastrati

Gani Kastrati

NOTERE

Ardjana A. Mediu